



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Priljefto/Prodato Received/Delivery	07-09-2023	3	viti god year
Organ./Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr. Prot. B: Prot. Prot. No.	Shlyca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHCK	3430/2023		1/5



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.389/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.389/2023 të datës 22.02.2023 të parashtruar nga ankuesja Albulena kundër Vendimit Nr.XII/34 i datës 21.02.2023 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Obiliqit, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 06.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.389/2023 e datës 22.02.2023 e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet Vendimi Nr.XII/34 i datës 21.02.2023, Njoftimi për vlerësimin përfundimtar i datës 13.02.2023 si dhe Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 13.02.2023 të nxjerra nga Komisioni i Pranimit të Komunës së Obiliqit, ndërsa *procedura e rekrutimit sipas Konkursit RN00010509 të datës 29.11.2022 kthehet në rishqyrtim* në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit të kandidatëve tek Komisioni i Pranimit.
- III. Obligohet Kryetari i Komunës së Obiliqit, që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesja me datë 21.02.2023 përmes e-mailit zyrtar [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net) ka parashtruar ankesë, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil është regjistruar me datë 22.02.2023 nën shenjën A.nr.389/2023 dhe numër protokollit:1968/2023, Vendimit Nr.XII/34 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Obiliqit i datës 21.02.2023 me pretendimin e vetëm ankimor se Komisioni i Pranimit me rastin e vlerësimit të ankueses në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit, ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike, pasi që të gjitha dokumentet e kërkuar sipas konkursit i kam bashkangjitur me rastin e aplikimit, më kërkesën që Këshilli të detyrojë Njësinë e Burimeve Njerëzore ta rivlerësoj dokumentacionin e dorëzuar nga ankuesja.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 06.03.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Komuna e Obiliqit. Ndërsa me datën 20.03.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave për shqyrtimin e kësaj ankese administroi këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 1968/2023 të datës 22.02.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshill; E-mailin e datës 21.02.2023 dërguar nga ankuesja në Këshill; Vendimin Nr.XII/34 e datës 21.02.2023 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Obiliqit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 06.03.2023; Përgjigjen në kërkesë e datës 20.03.2023; Konkursin e datës 29.11.2022; Listën e kandidatëve që kanë aplikuar; Njoftimin e datës 10.01.2023 lidhur me kandidatët që kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak; Vendimin për themelimin e Komisionit të Pranimit i datës 27.01.2023; Renditjen përfundimtare të kandidatëve e datës 13.02.2023; Rezultatet e vlerësimit përfundimtar i datës 13.02.2023; Ankesën e ankues të parashtruar në Komisionin e Pranimit me datë 14.02.2023; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Aplikacionin e ankueses të datës 02.12.2023; Diplomën e datës 05.07.2013 me numër:69/13 lëshuar nga Kolegji Universitar Biznesi; Diplomën e datës 20.06.2016 me numër:23/16 lëshuar nga Kolegji Universitar Biznesi; Çertifikatën e datës 15.01.2015 lëshuar nga IAS Consulting; Kontratën e punës së ankueses (data e pa lexueshme); referencën e datës 01.07.2012; Pasqyrën e llogarisë së trustit e datë 01.12.2021; Çertifikatën e lëshuar nga Gjykatat Themelore në Prishtinë-Dega Prishtinë e datës 02.12.2022; Formularët e vlerësimit të jetëshkrimit për të gjithë kandidatët.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruar nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesja është e *bazuar*, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Komuna e Obiliqit me datën 29.12.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialistë të Administrimit të Përgjithshëm me numër të referencës RN00010509 lidhur me pozitat "Asistent administrativ 3" në kuadër të Sektorit të Arsimit të Komunës së Obiliqit, me kriteret e përcaktuara si në vijim:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet .*

Kolegji i Këshillit sipas shkresave të lëndës, gjegjësisht aplikacionit të datës 02.12.2022 ka gjetur se në konkursin e shpallur ka aplikuar edhe ankuesja e cila ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, ndërsa në testin me shkrim kishte arritur 47 pikë, ndërsa për jetëshkrimin është

vlerësuar me gjithsejtë 9.6 pikë dhe si rrjedhojë nuk kishte arritur të grumbulloi gjithsejtë 60 pikë sa është e nevojshme për të iu nënshtruar edhe intervistës me gojë.

Ankuesja e pa kënaqur me vlerësimin e rezultateve dhe renditjes së kandidatëve, me datë 14.02.2023 ka parashtruar ankesë kundër Njoftimit për vlerësimin përfundimtar të datës 13.02.2023 pranë Komisionit të Pranimit me pretendimin ankimor se nuk është vlerësuar sikurse parashikohet dispozitat e ligjit material ngase e njëjta në konkurse nga institucione tjera për pozita të ngjashme ishte vlerësuar më shumë, ndërsa Komisioni i Pranimit me datës 21.02.2023 përmes vendimin Nr.XII/34 i ka refuzuara ankesën dhe ka lënë në fuqi vlerësimin përfundimtar të kandidatëve të datës 13.02.2023, me arsyetimin se ankuesja ka poseduar vetëm një certifikatë e cila nuk është vlerësuar ngase nuk përputhet me pozitën e shpallur, ndërsa sa i përket përvojës së punës e njëjta nuk është poentuar pasi që me konkurs nuk është kërkuar përvoja e punës për pozitë e shpallur.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të vetmit pretendim të ankueses ndërlidhur me vlerësimin e jetëshkrimit, me datë 27.03.2023 i është drejtuar Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për sqarime duke kërkuar në cilësi të provave materiale formularët e vlerësimit të jetëshkrimit për të gjithë kandidatët në procedurë me qëllim të verifikimit të metodologjisë së poentimit, ndërsa nga provat e siguruar përmes e-mailit të datës 28.03.2023, Kolegji i Këshillit ka ardhur në konstatimin se Komisioni i Pranimit me rastin e vlerësimit të jetëshkrimit të kandidatëve ka vepruar me dy standarde, gjegjësisht të katër anëtarët e Komisionit si vijon L.H, R.Z, F.G dhe H.M me rastin e vlerësimit tek kategoria e vlerësimit të përvojës së punës të gjithë kandidatët në procedurë i kanë vlerësuar me zero (0) pikë, kurse anëtari i Komisionit M.K në cilësi të Ekspertit të Jashtëm tek kjo pjesë të gjithë kandidatët i ka vlerësuar, e që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit kjo është metodologjia e vlerësimit që është dashur të ndjekjet nga Komisioni i Pranimit.

Me qëllim të shqyrtimit të mëtejme të pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 22 paragrafi 2, 3 dhe 4 nën paragrafi 4.1, 4.2 dhe 4.3 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *"2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën dyzet (40) pikë në testimin me shkrim, i nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit. 3.Vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e cilësisë dhe nivelit të arsimimit, të përvojës domethënëse në punë dhe të trajnimeve që lidhen me vendin e punës në lëminë përkatëse të lidhur më Grupin për të cilët zhvillohet konkurrimi. 4.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri në njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri në tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin të arsimimit; 4.2. deri në shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet"* dhe ka ardhur në përfundimin se katër anëtarët e Komisionit të Pranimit të cilët të gjithë kandidatët në procedurën e vlerësimit të jetëshkrimit i kanë poentuar me zero (0) pikë kanë vepruar gabimisht, ngase të njëjtit është dashur ta kenë parasysh sepse poentimi me zero (0) pikë është vlerësim negativ dhe jo mos vlerësim sikurse janë arsyetuar në vendim, nga rrjedh se meqenëse çështja e vlerësimit të përvojës së punës është kriter obligativ sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, atëherë në rastet kur për një pozitë të shpallur nuk kërkohet përvojë punë, vlerësimi duhet të jetë maksimal, pra shtatë (7) pikë pa dallim për të gjithë kandidatët, pasi që duke iu referuar 22 paragrafi 5 të së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: *"Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit, bën vlerësimin e detajuar për secilën prej faktorëve të përcaktuara në pajtim me paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni. Vlerësimi përfundimtar i jetëshkrimit për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve"* rrjedh se vlerësimi me zero (0) pikë për një fushë e cila nuk është e kërkuar sipas kritereve të konkursit i dëmton kandidatët në procedurën e vlerësimit

sipas mesatares së përgjithshme aritmetike, pasi që vetëm kandidatët që arrijnë të grumbullojnë 60 pikë nga vlerësimi i testimit me shkrim dhe jetëshkrimit arrijnë të kalojnë në fazën e vlerësimit të intervistës sikurse përcaktohet me nenin 23 paragrafi 2 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës.

Prandaj, sikurse u tha më lartë, mbi bazën e shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstatimeve të dhëna si dhe analizimin e dispozitave ligjore të ligjit material dhe rregullores së lartcekur, Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se Vendimin Nr.XII/34 i Komisioni i Pranimit i 21.02.2023 është i paligjshëm sikurse përcaktohet me dispozitat e nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material”*, ngase Komisioni i Pranimit nuk ka arritur të shqyrtojë meritorisht pretendimin e palës ankuese, sikurse vlerësimi lidhur me jetëshkrimin ishte bërë në kundërshtim me frymën e rregullores së pranimit dhe mbi këtë bazë Vendimi Nr.XII/34 i Komisioni i Pranimit i 21.02.2023, Njoftimi për vlerësimin përfundimtar të datës 13.02.2023 si dhe formulari i renditjes përfundimtare të kandidatëve të Komisionit të Pranimit i datës 13.02.2023 shfuqizohen sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Si rezultat i kësaj, Kolegji i Këshillit, konstaton se procedura e pranimit sipas konkursit me Nr. reference RN0001059 për grupin “Specialist i Administrimit të Përgjithshëm”, për pozitën e punës “Zyrtar Administrativ”, nga faza vlerësimit të jetëshkrimit është përcjellë me shkelje procedurale, andaj në këtë kuptim me qëllim të eliminimit të shkeljeve procedura e vlerësimit sipas konkursit të datës 29.12.2022 kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni i Pranimit në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit për të gjithë kandidatët të cilët e kanë kaluar testin me shkrim.

Nga se u tha si më latë, Kolegji i Këshillit konstaton se ka mbetur në fuqi konkursi me Nr. reference RN0001059 për grupin “Specialist i Administrimit të Përgjithshëm”, për pozitën e punës “Zyrtar Administrativ”, sikurse edhe vlerësimi i rezultateve me shkrim, ndërsa Komisioni i Pranimit me rastin e rishqyrtimit të lëndës duhet të respektoje vërejtjet e dhëna juridike në arsyetimin e këtij vendimi.

Andaj, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, gjegjësisht nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur i cili pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.389/2023

Flakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

